 Nëse pajisja juaj përdor R600a si lëndë ftohëse - mund ta mësoni këtë informacion nga etiketa në ftohësi - duhet të bëni kujdes gjatë transportit dhe instalimit për të mos lejuar që elementët ftohës të pajisjes të dëmtohen. Megjithëse R600a është një gaz natyror i padëmshëm për mjedisin. Meqenëse është shpërthyes, në rast të ndonjë rrjedhjeje të shkaktuar nga dëmtimi në elementët ftohës, largojeni frigoriferin nga flakët ose burimet e nxehtësisë dhe ajroseni dhomën për disa minuta ku ndodhet pajisja.

- Mbani të gjitha paketimet larg nga fëmijët dhe hidhni ato në mënyrë të duhur.
- Ndërsa e lëvizni dhe vendosni frigoriferin, mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës.
- Mos vendosni substanca shpërthyes si kanaçe aerosoli me lëndë të djegshme në këtë pajisje.
- Kjo paisje përdoret vetëm për ruajtjen e ushqimeve dhe pijeve.
- Kjo paisje është krijuar për përdorim shtëpiak në ambient të brendshëm.
- Kjo paisje mund të përdoret në: zyra, dhoma hoteli, dhoma bujtine, dhoma hoteli rural, si dhe në vende të ngjashme ku përdorimi nuk tejkalon (mesatarisht) nivelet e përdorimit shtëpiak.
- Nëse priza nuk përputhet me spinën e frigoriferit, ajo duhet të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose nga persona të tillë të kualifikuar me qëllim që të shmangni rreziqet.
- Një spinë tokëzimi specifike është lidhur kabllon e korrentit të frigoriferit tuaj. Kjo spinë tokëzimi duhet të përdoret me një posaçërisht spinë tokëzimi nga 16 amper ose 10 amper sipas vendit ku produkti do të shitet. Nëse nuk ka prizë të tillë në shtëpinë tuaj, instalojeni me një elektrikist të autorizuar.

- Kjo aparaturë mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe personat me aftësi të pakësuara fizike, të ndjesisë ose mendore ose mungesë të përvojës dhe njohurisë nëse u është dhënë mbikëqyrje ose udhëzime në lidhje me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet që përfshihen. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit nuk duhet bërë nga fëmijë pa mbikëqyrje.
- Fëmijët e moshave nga 3 deri në 8 lejohen të ngarkojnë dhe shkarkojnë pajisjet frigoriferike. Prej fëmijëve nuk pritet të kryejnë pastrim ose mirëmbajtje të përdoruesit të pajisjes, fëmijët shumë të vegjël (0-3 vjeç) nuk pritet të përdorin pajisjen, fëmijët e vegjël (3-8 vjeç) nuk pritet të përdorin vetëm nëse janë në mbikëqyrje të vazhdueshme, fëmijët e rritur (8-14 vjeç dhe personat e ndjeshëm mund të përdorin pajisjet me kujdes pasi t'u jepet mbikëqyrje e duhur ose udhëzime lidhur me përdorimin e pajisjes. Personat shumë të prekshëm nuk pritet të përdorin pajisjet sigurt vetëm nëse ju jepet mbikëqyrje e vazhdueshme.
- Nëse kablloja e korrentit është e dëmtuar, ai duhet të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimit ose nga persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur rrezikun.
- Kjo pajisje nuk është bërë për përdorim në lartësi më tepër se 2000 m.

Për të shmangur kontaminimin e ushqimit, ju lutemi respektoni udhëzimet e mëposhtme:

- Hapja e derës për periudha të gjata mund të shkaktojë një rritje të ndjeshme të temperaturës në pjesët e pajisjes.
- Pastroni rregullisht sipërfaqet që mund të shkaktojnë një rritje të ndjeshme të temperaturës në pjesën e pajisjes.
- Rruani mishin dhe peshkun në kontejnerë të përshtatshëm në frigorifer, në mënyrë që ato të mos jenë në kontakt me akullore dhe ushqime të tjera.
- Njësitë për ushqim të ngrirë me dy yje janë të përshtatshme për ruajtjen e ushqimit të ngrirë, ruajtjen ose bërjen e akullores dhe bërjen e kubeve prej akulli.
- Njësitë me një, dy dhe tre yje nuk janë të përshtatshme për ngrirje të ushqimit të freskët.
- Nëse pajisja frigoriferike është lënë bosh për periudha të gjata, fikenit, shkrini, pastroni, thani dhe lëreni derën e hapur për të parandaluar zhvillimin e mykut brenda në pajisje.

Riparimi

- Për ta riparuar pajisjen tuaj, ju lutem kontaktoni Qendrën e Autorizuar për Servisim ose Riparim Përdor vetëm pjesë origjinale rezervë
- Ju lutemi mos harroni se vetë-riparimi ose riparimi nga persona të paautorizuar mund të sjell pasoja për sigurinë tuaj dhe shfuqizon garancinë.
- Pjesët vijuese rezervë do të jenë në dispozicion 7 vite pasi modeli të jetë ndërprerë: termostatë, ndjesorë të temperaturës, plakat e shtypura elektrike, burimet e dritës, dorezat e dymëve, menteshat e dymëve, govata dhe kanistra.
- Ju lutemi mbani mend se disa nga këto pjesë mund të jenë në dispozicion vetëm për riparuesit profesional, dhe se jo të gjithë pjesët rezervë janë relevante për të gjithë modelet.
- Rondelat e derës do të jenë në dispozicion 10- vite pasi të ndërpritet modeli.

Informacione sigurie

- Ndërsa e lëvizni dhe vendosni frigoriferin, bëni kujdes të mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës.
- Nëse frigoriferi juaj ka një çelës, prisheni ose hiqeni çelësin para se ta hidhni pasi fëmijët mund të bllokohen brenda dhe mund të shkaktojë aksident.

Shënime të rëndësishme

- Kjo pajisje është prodhuar që të përdoret në ambiente të brendshme dhe duhet të përdoret vetëm për të ruajtur ushqime. Nuk është e përshtatshme për qëllime tregtare dhe ky lloj përdorimi do ta bëjë garancinë të pavlefshme.

Hedhja e pajisjes së vjetër

Frigoriferit dhe ngrirësit e vjetër përmbajnë material izolimi dhe ftohës me CFC. Prandaj, duhet bërë kujdes të mos dëmtoni mjedisin kur hidhni frigoriferët e vjetër dhe të siguroheni që të zbatoni rregullat vendase.




Simboli mbi produkt ose mbi paketim tregon që ky produkt mund të mos trajtohet si mbeturina shtëpiake. Por në vend të kësaj duhet dorëzuar pikës së caktuar të mbledhjes për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Me sigurimin se ky produkt hidhet në mënyrë të duhur, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor, të cilat ndryshe do të mund të shkaktoheshin nga trajtimi joadekuat i mbeturinave të këtij produkti. Për informacione më të hollësishme në lidhje me riciklimin e këtij produkti, ju lutem kontaktoni zyrën tuaj lokale në qytetin tuaj, shërbimin e mbeturinave të shtëpisë suaj apo shitoren ku e keni blerë produktin.

Paralajmërimi sigurie

- Mos përdorni priza të shumëfishta ose kablo zgjatues.
- Mos futni spina të dëmtuara, të zhveshura ose të vjetra.
- Mos e tërhiqni, përthyeri ose dëmtoni kablun.



- Mos përdorni përshtatës spine.
- Kjo pajisje është bërë për t'u përdorur nga të rriturit, mos i lini fëmijët të luajnë me pajisjen ose të varen mbi derë.
- Mos futni ose nxirni spinën nga priza me duar të lagura për të shmangur zënien e korrentit.
- Mos vendosni shishe qelqi ose kanaçe pijesh në dhomën e ngrirësit. Shisheet ose kanaçet mund të shpërthejnë.
- Për sigurinë tuaj mos vendosni materiale shpërthyes ose të djegshme brenda frigoriferit. Vendosini pijet me sasi të lartë alkooli në pozicion vertikal në ndarjen e frigoriferit dhe duke i mbyllur grykat fort.
- Kur merrni akull të bërë në dhomën e ngrirësit, mos e prekni, akulli mund të shkaktojë djegie dhe/ose prerje akulli.




- Mos i prekni gjërat e ngrira me duar të lagura! Mos i hani akulloret dhe kubat e akullit menjëherë pasi t'i keni nxjerrë nga dhoma e ngrirësit!
- Mos i ngrini përsëri ushqimet e ngrira pasi kanë shkrire. Kjo mund të shkaktojë probleme shëndetësore si helmim nga ushqimi.
- Mos e mbulonit trupin ose kreun e frigoriferit me leckë. Kjo ndikon në performancën e frigoriferit tuaj.
- Fiksojini aksesorët në frigorifer gjatë transportit për të parandaluar dëmtimin e tyre.



Instalimi dhe përdorimi i frigoriferit tuaj


Para se të filloni ta përdorni frigoriferin tuaj, duhet t'i kushtoni vëmendje pikave të mëposhtme:

- Tensioni i punës për frigoriferin tuaj është 220-240 V në 50Hz.
- Ne nuk mbajmë përgjegjësi për dëmtimet që ndodhin për shkak të përdorimit pa tokëzim.
- Vendoseni frigoriferin në një vend ku nuk do të ekspozohet nën dritën direkte të diellit.
- Pajisja juaj duhet të jetë të paktën 50 cm larg nga sobat, furrat me gaz dhe pajisjet e ngrohjes dhe duhet të jetë të paktën 5 cm larg nga furrat elektrike.
- Frigoriferi juaj nuk duhet të përdoret asnjëherë jashtë ose të lihet nën shi.
- Mos vendosni asgjë mbi frigorifer dhe montojeni frigoriferin në një vend të përshtatshëm në mënyrë që sipër të ketë të paktën 40 mm hapësirë.
- Këmbët e para të lëvizshme duhet të rregullohen në mënyrë që pajisja të jetë në nivel dhe e palëvizshme. Mund t'i rregulloni këmbët duke i rrotulluar ato në drejtim të akrepave të orës (ose në drejtim të kundërt). Kjo mund të bëhet para se të vendosni ushqim në frigorifer.
- Para se ta përdorni frigoriferin tuaj, fshijini të gjitha pjesët me ujë të ngrohtë me një lugë çaji bikarbonat sode, dhe pastaj shëplajeni me ujë të pastër dhe thajeni. Vendosini të gjitha pjesët pas pastrimit.
- Montoni shinën plastike (pjesa me fletë të zeza prapa) duke e rrotulluar 90° siç tregohet në figurë për të mos e lejuar kondensatorin të prekë murin.
- Distanca mes pajisjes dhe murit të pasmë patjetër të jetë minimum 42 mm dhe maksimum 75 mm.



Para se të përdorni frigoriferin tuaj

- Kur përdoret për herë të parë ose pas transportit, mbajeni frigoriferin tuaj në pozicion drejt për 3 orë dhe futeni në prizë për të lejuar punim të efektshëm. Përndryshe mund të dëmtoni kompresorin.
- Frigoriferi juaj mund të ketë një erë kur përdoret për herë të parë; era do të largohet kur frigoriferi fillon të ftohet.



Ndriçim i brendshëm




PARALAJMËRIM!

Rrezik nga tronditja elektrike.

- Ky produkt përmban një burim drite të klasit F të efikasitetit të energjisë.
- Sa u përket dritave të brendshme në këtë produkt dhe pjesët rezervë që shiten veçmas: Këto llamba synojnë të qëndrojnë në kushte e skajshme fizike te pajisjet shtëpiake, si temperaturën, vibrime, lagështinë, ose synojnë të sinjalizojnë të dhëna lidhur me statusin operacional të pajisjes. Ata synojnë të përdoren te pajisjet tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçimin e dhomës shtëpiake.

Dimensionet



Dimensionet e përgjithshme¹

H1	mm	2010
W1	mm	595
D1	mm	650

¹ lartësia, gjerësia dhe thellësia e pajisjes pa dorezë

Hapësira e nevojshme në përdorim²

H2	mm	2160
W2	mm	695
D2	mm	739

² lartësia, gjerësia dhe thellësia e pajisjes duke përfshirë dorezën, plus hapësirën e nevojshme për qarkullimin e ajrit të ftohtë

Hapësira e përgjithshme e nevojshme në përdorim³

W3	mm	963
D3	mm	1179

³ lartësia, gjerësia dhe thellësia e pajisjes duke përfshirë dorezën, plus hapësirën e nevojshme për qarkullim të lirë të ajrit ftohtë, plus hapësirën e nevojshme për të lejuar hapjen e derës në kënd minimal që do të mundëson largimin e tërë pajisjes së brendshme

KAPITULLI - 2. FUNKSIONET DHE MUNDËSITË E NDRYSHME


Informacione rreth teknologjisë së ftohjes të gjeneratës së re

Frigoriferët me teknologjinë e ftohjes të gjeneratës së re kanë sistem të ndryshëm punimi nga frigoriferët statikë. Në frigoriferët normalë, ajri i lagësht që hyn në frigorifer dhe avulli i ujit që del nga ushqimet, akumulon formimin e akullit në pjesën e ngrirjes. Për të hequr këtë ngrirje, me fjalë të tjera, për ta shkrirë, duhet të ndalohet frigoriferi. Gjatë periudhës së ndalimit, për t'i mbajtur ushqimet të ftohta, përdoruesi duhet të nxjerrë ushqimin jashtë frigoriferit dhe përdoruesi duhet të pastrojë akullin gjatë kësaj periudhe.

Në frigoriferët me teknologjinë e ftohjes të gjeneratës së re, situata në pjesën e ngrirjes është krejt ndryshe. Me ndihmën e ventilatorit, ajri i ftohtë dhe i thatë futet në shumë pika në pjesën e ngrirjes. Si rezultat i ajrit të ftohtë që fryn në mënyrë homogjene, edhe në hapësirat midis rafteve, ushqimet ngrihen njëllëj dhe saktë. Nga ana tjetër, nuk do të ketë formim ngrice.

Në pjesën e frigoriferit, do të jetë thuajse i njëjti konfigurim si në pjesën e ngrirjes. Ajri, që del me ventilatorin i cili ndodhet sipës pjesës së frigoriferit, ftohet ndërsa kalon në hapësirën mbrapa tubacionit të ajrit. Në të njëjtën kohë, ajri del nga vrimat në tubacionin e ajrit në mënyrë që procesi i ftohjes të mbarojë me sukses në pjesën e frigoriferit. Vrimat në tubacionin e ajrit janë bërë të tilla që të bëhet shpërndarje homogjene në këtë pjesë.


Meqenëse nuk ka kalim ajri midis ngrirjes dhe frigoriferit, nuk do të ketë bashkim të erërave. Si rezultat i këtyre, frigoriferi juaj me teknologjinë e re të ftohjes ju jep lehtësi përdorimi përveç vëllimit të madh dhe pamjes estetike.



Ekрани dhe paneli i kontrollit

Përdorimi i panelit të kontrollit

1. Mundëson vendosjen e parametrave të ngrirësit.
2. Mundëson vendosjen e parametrave të ftohësit.
3. Ekрани për vendosjen e vlerës së ngrirësit.
4. Ekрани për vendosjen e vlerës së ftohësit.
5. Simboli i modalitetit të ekonomisë.
6. Simboli i super ngrirjes.
7. Simboli i alarmit.



Përdorimi i ngrirësit të frigoriferit

Ndriçim (nëse ka)

Kur produkti lidhet me rrymë elektrike për së pari herë, dritat e brendshme mund të kyçet 1 minutë më vonë për shkak të testeve të hapjes.

Sapo ta keni lidhur produktin, të gjitha simbolet do të shfaqen për 2 sekonda dhe vlerat fillestare do të tregohen si -18 °C në treguesin e rregullimit të ngrirësit dhe $+4\text{ °C}$ në treguesin e rregullimit të frigoriferit.

Parametrat e temperaturës të ngrirësit

- Vlera fillestare e temperaturës për treguesin e parametrave të ngrirësit është -18 °C .
- Shtypni butonin e vendosjes së ngrirësit një herë
Kur e shtypni butonin së pari, vlera e mëparshme do të pulsojë në ekran.
- Kurdo që shtypni këtë çelës ose buton, temperatura do të ulet.
- Nëse vazhdoni ta shtypni butonin, do të fillojë përsëri nga -16 °C .

SHËNIM: Modaliteti Eko aktivizohet automatikisht kur temperatura e ndarjes së ngrirësit është vendosur në -18 °C .



Parametrat e temperaturës së ftohësit

- Vlera fillestare e temperaturës për treguesin e parametrave të ftohësit është $+4\text{ °C}$.
- Shtypni butonin e ftohësit njëherë
- Kurdo që shtypni këtë çelës ose buton, temperatura do të ulet.
- Nëse vazhdoni ta shtypni butonin, do të fillojë përsëri nga $+8\text{ °C}$.

Modaliteti i Super ngrirjes

Qëllimi

- Për të ngrirë një sasi të madhe ushqimesh që nuk mund të futen në raftin e ngrirjes së shpejtë.
- Për të ngrirë ushqime të përgatitura.
- Për të ngrirë ushqime të freskëta shpejt me qëllim që të ruhet freskia.

Si ta përdorni

Për ta aktivizuar modalitetin e super ngrirjes, shtypni dhe mbani shtypur butonin e konfigurimit të temperaturës së ngrirësit për 3 sekonda. Sapo të jetë vendosur modaliteti i super ngrirjes, simboli i super ngrirjes në tregues do të ndizet dhe makina do të lëshojë një sinjal për të konfirmuar se modaliteti është aktivizuar.



Gjatë modalitetit të super ngrirjes:

- Temperatura e ftohësi mund të rregullohet. Në këtë rast do të vazhdojë metoda e super ngrirjes.
- Nuk mund të zgjidhet modaliteti i ekonomisë.
- Modaliteti i super ngrirjes mund të anulohet në të njëjtën mënyrë siç është përzgjedhur.

Shënim:

- Shuma maksimale e ushqimeve të freskëta (në kilogramë) që mund të ngrihen në periudhën prej 24 orësh është treguar në etiketën e pajisjes.
- Për performancë optimale në kapacitetin maksimal të ngrirjes, aktivizoni modalitetin e super ngrirjes 3 orë para se të futni ushqim të freskët në ngrirës.



Modaliteti i super ngrirjes do të anulohet automatikisht pas 24 orësh në varësi të temperaturës së ambientit ose kur sensori i ngrirjes të arrijë një temperaturë mjaftueshëm të ultë.

Parametrat e rekomanduara për temperaturën e ngrirësit dhe ndarjes së ftohësit.

Ndarja e ngrirësit	Ndarja e ftohësit	Vërejtje
-18 °C	4 °C	Për përdorim të rregullt dhe performancë më të mirë.
-20 °C, -22 °C or -24 °C	4 °C	Rekomandohet kur temperatura e ambientit tejkalon 30 °C.
Modaliteti i super ngrirjes	4 °C	Duhet të përdoret kur dëshironi të ngrini ushqimin në një periudhë të shkurtër kohore.
-18 °C, -20 °C, -22 °C or -24 °C	2 °C	Këto parametra të temperaturës duhet të përdoren kur temperatura e ambientit është e lartë ose nëse mendoni se ndarja e frigoriferit nuk është mjaft e ftohtë, sepse dera është hapur shpesh.

Funksioni i alarmit të derës së hapur

Nëse dera e frigoriferit mbetet e hapur për më shumë se 2 minuta, pajisja do të lëshojë sinjal.

Paralajmërimet për rregullimet e temperaturës

- Rregullimet e temperaturës duhet të bëhen sipas shpeshësisë së hapjes së derës dhe sasisë së ushqimeve të mbajtura në frigorifer.
- Mos kaloni te një rregullim tjetër pa përfunduar një rregullim aktual.
- Frigoriferi juaj duhet të përdoret për deri në 24 orë sipas temperaturës së ambientit pa ndërprerje pasi ta vini në prizë për ftohje të plotë. Mos e hapni shpesh derën e frigoriferit dhe mos vendosni shumë ushqime në të gjatë kësaj periudhe.
- Kur hiqni spinën dhe më pas e vendosni përsëri në prizë për ta përdorur ose kur shkëputet energjia elektrike, zbatohet një funksion i vonësës me 5 minuta për të parandaluar dëmtimin e kompresorit të frigoriferit. Frigoriferi juaj do të fillojë të funksionojë normalisht pas 5 minutash.
- Frigoriferi juaj është i projektuar për të funksionuar në intervalet e temperaturës së ambientit të deklaruar në standardet përkatëse, sipas klasës së klimës të deklaruar në etiketën informative. Ne nuk rekomandojmë përdorimin e frigoriferit në temperatura jashtë kufijve të vlerave të deklaruara, në lidhje me efektivitetin e ftohjes.


- Kjo pajisje është bërë për t'u përdorur në temperatura ambienti brenda intervalit 10°C - 43°C.

Kategoria e klimës	Kuptimi	Temperatura e ambientit
T	Tropikale	Kjo pajisje ngrirëse ose ftohëse synon të përdoret në temperaturë ambientale duke filluar nga 16 C deri 43 C.
ST	Subtropikale	Kjo pajisje ftohëse synon të përdoret në temperaturë ambientale duke filluar nga 16 C deri 38 C.
N	Temperatura e butë	Kjo pajisje ftohëse synon të përdoret në temperaturë ambientale duke filluar nga 16 C deri 32 C.
SN	Temperatura e zgjeruar	Kjo pajisje ftohëse synon të përdoret në temperaturë ambientale duke filluar nga 10 C deri 32 C.

Aksesorët

Forma e akullit

- Mbushni formën e akullit me ujë dhe vendoseni në ndarjen e ngrirësit.
- Pasi uji të kthehet plotësisht në akull, mund të rrotulloni formën si më poshtë për të marrë kubat e akullit.



Kutia e ngrirësit

Kutia e ngrirjes lejohet që ushqimet të mbahen më me rregull.

Heqja e kutisë të ngrirësit;


- Tërhiqeni kutinë jashtë sa më shumë të jetë e mundur.
- Tërhiqeni lart dhe jashtë pjesën e parme të kutisë.



Bëni të njëjtin veprim në të kundërt për të rivendosur pjesën rrëshkitëse.



Shënim: Gjithmonë kapni dorezën e kutisë kur hiqni kutinë.




Dhoma Extra Chill (Ftohje Ekstra) (në disa modele)

Ideale për të ruajtur shijen dhe teksturën e ushqimeve të freskëta dhe të djathit. Sirtari me tërheqje siguron një mjedis me temperaturë më të ulët krahasuar me pjesën tjetër të frigoriferit, falë qarkullimit aktiv të ajrit të ftohtë.

Heqja e raftit të çillerit


- Tërhiqeni raftin e çillerit drejt vetes duke e rrëshqitur në shina.
- Tërhiqeni raftin e çillerit lart nga shinat për ta hequr.



Butoni i freskisë (në disa modele)

Në rast se ndarja e perimeve është plotësisht e mbushur, butoni i freskisë që ndodhet përpara ndarjes së perimeve duhet të hapet. Në këtë mënyrë kontrollohet ajri në ndarjen e perimeve dhe niveli i lagështisë si dhe do të rritet jetëgjatësia e ushqimeve.


Nëse shikoni kondensime në raftin e xhamit, duhet ta hapni këtë kllapë që ndodhet prapa raftit.





Përshkrimet vizuale dhe tekst në pjesën e aksesorëve mund të ndryshojnë në varësi të modelit të pajisjes tuaj.

KAPITULLI - 3. RREGULLIMI I USHQIMIT NË PAJISJE

Ndarja e frigoriferit

- Ndarja e ushqimeve të freskëta është ajo e shënuar (në markën e fabrikës) me .
- Për të ulur lagështinë dhe rritjen e mëpasshme të akullit, mos vendosni kurrë lëngje në kontejnerë të pambyllur në frigorifer. Akulli ka tendencën të përqendrohet në pjesët më të ftohta të aparatit të avullimit dhe me kalimin e kohës do të kërkojë shkrirje më të shpeshtë.
- Mos vendosni kurrë ushqime të ngrohta në frigorifer. Ushqimet e ngrohta duhet të lihen të ftohen në temperaturën e dhomës dhe duhet të rregullon për të siguruar qarkullimin e mirë të ajrit në ndarjen e frigoriferit.
- Asgjë nuk duhet të prekë murin e pasmë pasi do të shkaktojë akull dhe paketimi mund të ngjitet në murin e pasmë. Mos e hapni shumë shpesh derën e frigoriferit.
- Rregulloni mishin dhe peshkun e pastruar (mbështjellë në pako ose qese plastike) që do t'i përdorni për 1-2 ditë në pjesën e poshtme të ndarjes së frigoriferit (mbi ndarjen e perimeve) pasi kjo është pjesa më të ftohtë dhe do të garantojë kushte më të mira të ruajtjes.
- Ju mund t'i vendosni frutat dhe perimet në ndarjen e perimeve pa i paketuar.


 **SHËNIM:** Përdorimi më efektiv i energjisë sigurohet në konfiguracionin me sirtarët në pjesën e poshtme të pajisjes, dhe raftet e radhitura njëtrajtshëm, pozita e rafteve të derës nuk e ndikon konsumin e energjisë.

 Disa rekomandime janë të specifikuara më poshtë për vendosjen dhe ruajtjen e ushqimeve në ndarjen e ftohjes.

Ushqim	Koha maksimale e ruajtjes	Ku ta vendosni ushqimin në dhoma e frigoriferit
Perimet dhe frutat	1 javë	Koshi i perimeve
Mishi dhe peshku	2 - 3 ditë	Mbështjellë me fletë plastike ose qese ose në një kuti mishi (mbi raftin prej xhami)
Djathi i freskët	3 - 4 ditë	Në raftin e veçantë të derës
Gjalpi dhe margarina	1 javë	Në raftin e veçantë të derës
Produktet në shishe qumështi dhe kosi	Deri në datën e skadimit të rekomanduar nga prodhuesi	Në raftin e veçantë të derës
Vezët	1 muaj	Në raftin e vezëve
Ushqimi i gatuar	2 ditë	Të gjitha raftet

 **SHËNIM:** Patatet, qepët dhe hudhrat nuk duhet të ruhen në frigorifer.

Ndarja e ngrirësit

- Dhoma ose ndarja e ngrirësit është ajo e shënuar me .
- Përdorimi i ngrirësit është për ngrirje të thellë ose ushqime të ngrira për periudha të gjata kohe si dhe bërjen e kubave të akullit.
- Për të arritur kapacitetin maksimal për ndarjen e ngrirësit, ju lutemi përdorni vetëm raftet e xhamit për sektorin e sipërm dhe të mesëm. Për sektorin e poshtëm, ju lutemi përdorni shportën e poshtme.

- Për të ngrirë ushqimet e freskëta, sigurohuni që pjesa më e madhe e sipërfaqes së ushqimeve për ngrirje të jetë në kontakt me sipërfaqen e ftohjes.
- Mos i vendosni ushqimet e freskëta dhe të ngrira pranë njëra-tjetrës pasi mund të shkrijnë ushqimet e ngrira.
- Gjatë ngrirjes së ushqimeve të freskëta (d.m.th. mish, peshk dhe mish i grirë), ndajini në pjesë sipas përdorimit.
- Kur njësia të shkrijë, rivendosini ushqimet në ngrirës dhe mos harroni t'i konsumoni në një periudhë të shkurtër.
- Mos vendosni kurrë ushqime të ngritura në ndarjen e ngrirësit. Kjo do të ngacmojë ushqimet e ngrira.
- Për ruajtjen e ushqimeve të ngrira duhet të ndiqni gjithmonë me kujdes ushqimet në paketimin e ushqimeve të ngrira dhe nëse nuk keni informacione, ushqimet nuk duhet të ruhen për më shumë se 3 muaj nga data e blerjes.
- Kur të blini ushqime të ngrira, sigurohuni që janë ngrirë në një temperaturë të përshtatshme dhe që paketimi është i padëmtuar.
- Ushqimet e ngrira duhet të transportohen në kontejnerë të përshtatshëm për të ruajtur cilësinë e ushqimeve dhe duhet të kthehen në sipërfaqen e ngrirjes në njësi në një kohë sa më të shkurtër.
- Nëse një pako me ushqime të ngrira shfaq shenja lagështie ose erë jonormale, ka mundësi që të jetë ruajtur më parë në një temperaturë të papërshtatshme dhe që përmbajtja e saj të jetë e dëmtuar.
- Jetëgjatësia e ruajtjes e ushqimeve të ngrira varet nga temperatura e dhomës, përcaktimi i termostatit, shpeshësia e hapjes së derës, llojit të ushqimeve dhe gjatësisë së kohës për transportin e produktit nga dyqani në shtëpi. Ndiqni gjithmonë udhëzimet e printuara në paketim dhe mos kaloni asnjëherë afatin maksimal të ruajtjes të shënuar.


Kini parasysh se, nëse dëshironi ta hapni përsëri derën e ngrirësit pasi ta keni mbyllur, ajo nuk do të hapet me shumë lehtësi. Kjo gjë është shumë normale! Pasi të arrijë gjendjen e ekuilibrit, dera do të hapet përsëri me lehtësi.

Shënim i rëndësishëm:

- *Ushqimet e ngrira, kur shkrihen, duhet të gatohen si ushqimet e freskëta. Nëse nuk gatohen pasi të shkrihen, ato KURRË nuk duhet të ngrihen përsëri.*
- Shija e disa erëzave që gjenden në gatime (glikanxo, borzilok, lakërishte, uthull, erëza të përziara, xhenxhefil, hudhër, qepë, mustardë, trumzë, borzilok, piper i zi, etj.) ndryshojnë dhe marrin një shije të fortë kur ruhen për një periudhë të gjatë. Për këtë arsye, ushqimeve të ngrira duhet t'u shtohen pak erëza ose erëzat e dëshiruara duhet të shtohen pasi të shkrihen ushqimet.
- Periudha e ruajtjes së ushqimeve varet nga vaji i përdorur. Vajrat e përshtatshme janë margarina, dhjami i viçit, vaji i ullirit dhe gjalpi ndërsa vajrat e papërshtatshme janë vaji i kikirikut dhe dhjami i dërrit.
- Ushqimet në formë plastike duhet të ngrihen në kupa plastike dhe ushqimet e tjera duhet të ngrihen në fletë plastike ose qese.

Disa rekomandime janë të specifikuara më poshtë për vendosjen dhe ruajtjen e ushqimeve në ndarjen me ngrirje të thellë.

Mishi dhe peshku	Përgatitja	Koha maksimale e ruajtjes (muaj)
Bifteku	Mbështjellje me letër	6 - 8
Mish qengji	Mbështjellje me letër	6 - 8
Rosto viçi	Mbështjellje me letër	6 - 8
Mishi viçi në kuba	Në copa të vogla	6 - 8
Mish qengji në kuba	Në copa	4 - 8
Mish i grirë	Në pako pa përdorur erëza	1 - 3
Mish shpendi (copa)	Në copa	1 - 3
Sallam/salsiçe Bolonja	Duhet të paktohet edhe nëse ka cipë	
Pulë dhe gjel	Mbështjellje me letër	4 - 6
Rosë dhe Patë	Mbështjellje me letër	4 - 6
Drer, Lepur, Derr i Egër	Në pjesë 2.5 kg dhe si fileta	6 - 8
Peshqit e ujërave të ëmbla (salmon, krap, lejlek, mustak)	Pasi të keni pastruar të brendshmet dhe halat e peshkut, lajeni dhe thajeni; dhe nëse është e nevojshme, pritni bishtin dhe kokën.	2
Peshk i hollë, levrek, shojzë, gjuhëz		4
Peshq të shëndoshë (Ton, Skumbri, peshk blu, sardele)		2 - 4
Gocë deti	I pastruar dhe në qese	4 - 6
Havjar	Në paketimin e vet, në enë alumini ose plastike	2 - 3
Kërmij	Në ujë me kripë, enë alumini ose plastike	3

 **Shënim:** Mishi i ngrirë duhet të gatuhet si mish i freskët pasi të jetë shkrirë. Nëse mishi nuk gatuhet pasi është shkrirë, nuk duhet ngrirë përsëri.

Perimet dhe Frutat	Përgatitja	Koha maksimale e ruajtjes (muaj)
Fasulet dhe bishtajat	Lajeni dhe priteni në copa të vogla dhe zjejeni në ujë	10 - 13
Fasulet	Zhvisheni dhe lajeni e zjejeni në ujë	12
Lakër	Pastrojeni dhe zjejeni në ujë	6 - 8
Karrota	Pastrojeni dhe priteni në copa dhe zjejeni në ujë	12
Specat	Priteni kërcellin, ndajeni në dy copa, hiqni bërthamën dhe zjejeni në ujë	8 - 10
Spinaq	Lajeni dhe zjejeni në ujë	6 - 9

Perimet dhe Frutat	Përgatitja	Koha maksimale e ruajtjes (muaj)
Lulelakër	Hiqni gjethet veç, pritni zemrën në copa dhe lëreni për ca kohë në ujë me pak lëng limoni.	10 - 12
Patëllxhan	Pritini në copa 2cm pasi t'i keni larë	10 - 12
Misër	Pastrojeni dhe mbështilleni me kërcellin ose si misër i ëmbël	12
Mollë dhe dardhë	Zhvishini dhe pritini në feta	8 - 10
Kajsitë dhe Pjeshkët	Pritini në dy copa dhe hiqeni farën	4 - 6
Luleshtrydhet dhe Manaferrat	Lajini dhe qërojini	8 - 12
Fruta të gatuar	Duke shtuar 10 % sheqer në enë	12
Kumbullat, qershitë, boronicat	Lajini dhe hiqni bishtat	8 - 12

	Koha maksimale e ruajtjes (muaj)	Koha e shkrirjes në temperaturë ambienti (orë)	Koha e shkrirjes në furrë (minuta)
Bukë	4 - 6	2 - 3	4-5 (220-225 °C)
Biskota	3 - 6	1 - 1,5	5-8 (190-200 °C)
Brumërat	1 - 3	2 - 3	5-10 (200-225 °C)
Byrek	1 - 1,5	3 - 4	5-8 (190-200 °C)
Byrek Filo	2 - 3	1 - 1,5	5-8 (190-200 °C)
Pica	2 - 3	2 - 4	15-20 (200 °C)

Produktet e qumështit	Përgatitja	Koha maksimale e ruajtjes (muaj)	Kushtet e ruajtjes
Qumësht i Paketuar (Homogjenizuar)	Në paketimin e vet	2 - 3	Qumësht i Pastër - Në paketimin e vet
Djathi - përveç djathit të bardhë	Në feta	6 - 8	Mund të përdoret paketimi origjinal për periudhë të shkurtër ruajtjeje. Duhet të mbështillet me letër për periudha të gjata.
Gjalpë, margarinë	Në paketimin e vet	6	

KAPITULLI - 4. RREGULLIMI I USHQIMIT NË PAJISJE




Shkëputeni njësinë nga priza para se ta pastroni.




Mos e pastroni pajisjen duke hedhur ujë.



Mos përdorni produkte, detergjente ose sapunë gërryes. Pasi t'i keni larë, shpëlajini me ujë të pastër dhe fshijini me kujdes. Kur të keni mbaruar veprimet e pastrimit, futeni përsëri spinën e njësisë me duar të thata.




- Dhoma e frigoriferit dhe ngrirësit duhet të pastrohet rregullisht duke përdorur një solucion të bikarbonatit të sodës dhe ujë të ngrohtë.



- Hiqni aksesoret individualisht dhe pastrojini ato me uje te ngrohte. Mos i lani ne lavastovilje.



- Kondensatori (pjesa me fletë prapa) duhet të pastrohet me fshesë me korrent ose furçë të paktën njëherë në vit. **Kjo do të bëjë që ngrirësi juaj të punojë më mirë dhe do t'ju ndihmojë të kurseni energji.**



Spina e korrentit duhet të shkëputet.

Shkrirja

Frigoriferi juaj ka shkrire plotësisht automatike. Uji i mbledhur si rezultat i shkrijes kalon përmes një gryke të grumbullimit të ujit, kalon në enën e avullimit poshtë kondensatorit dhe avullon atje.




Zëvendësimi i Ndrichimit LED

Nëse frigoriferi juaj ka një ndriçim LED, kontakto ndihmën teknike pasi kjo duhet të zëvendësohet vetëm nga personeli i autorizuar.

KAPITULLI - 5. TRANSPORTIMI DHE NDRYSHIMI I POZICIONIT TË INSTALIMIT

Transporti dhe ndryshimi i vendit të montimit

- Paketimi origjinal dhe shkuma duhet të ruhen për ri-transport (mundësisht).
- Duhet ta lidhni frigoriferin me paketim të trashë, rripa ose kordonë të fortë dhe ndiqni udhëzimet për transportin mbi paketim.
- Hiqni pjesët e lëvizshme (raftet, aksesorët, koshat e perimeve, etj.) ose fiksojini në frigorifer nga goditjet duke përdorur ngjitëse gjatë lëvizjes dhe transportit.



 **Mbajeni frigoriferin në pozicion vertikal.**

Ripozicionimi i derës

- Nuk është e mundur që të ndryshohet drejtimi i hapjes të derës të frigoriferit tuaj, nëse dorezat e derës në frigoriferin tuaj janë montuar nga sipërfaqja e parme e derës.
- Është e mundur të ndryshohet drejtimi i hapjes së derës tek modelet pa doreza ose modelet me doreza të montuara anësh.
- Nëse mund të ndryshohet drejtimi i hapjes së derës mbi frigoriferin tuaj duhet të kontaktoni me Shërbimin e Autorizuar më të afërt që të ndryshoni drejtimin e hapjes.

KAPITULLI - 6. PARA SE TË THËRRISNI SHËRBBIMIN E PAS SHITJES

Kontrolloni paralajmërimet

Frigoriferi ju paralajmëron nëse temperaturat për freskuesin dhe ngrirësin janë në nivele të papërshtatshme ose kur ka një problem me pajisjen. Kodet paralajmërues paraqiten në treguesit e ngrirësit dhe të freskuesit.

LLOJI I GABIMIT	KUPTIMI	PSE	ÇFARË TË BËNI
E01	Paralajmërim sensori		Thërrisni shërbimin për ndihmë sa më shpejt të jetë e mundur.
E02			
E03			
E06			
E07			
E08	Paralajmërim për tension të ulët	Energjia në pajisje ka rënë nën 170 V.	<ul style="list-style-type: none"> - Ky nuk është defekt në pajisje, ky gabim ndihmon në parandalimin e dëmtimeve në kompresor. - Duhet të rritet tensioni përsëri në nivelet e kërkuara. <p>Nëse ky paralajmërim vazhdon, duhet të kontaktohet një teknik i autorizuar.</p>

LLOJI I GABIMIT	KUPTIMI	PSE	ÇFARË TË BËNI
E09	Ndarja e ngrirësit nuk është e ftohtë mjaftueshëm	Ka të ngjarë të ndodhë pas një ndërprerjeje energjie për kohë të gjatë.	<p>1. Vendosni temperaturën e ngrirjes në një vlerë më të ftohtë ose vendosni Super Ngrirje. Kjo duhet të eliminojë kodin e gabimit pasi të arrihet temperatura e kërkuar. Mbajini dyert të mbyllura për të shkurtuar kohën që duhet për të arritur temperaturën e saktë.</p> <p>2. Hiqni çdo produkt që mund të jetë shkrirë gjatë këtij gabimi. Ato mund të përdoren brenda një periudhe kohe të shkurtër.</p> <p>3. Mos shtoni ushqime të freskëta në pjesën e ngrirjes derisa të jetë arritur temperatura e saktë dhe ky gabim të mos jetë më.</p> <p>Nëse ky paralajmërim vazhdon, duhet të kontaktohet një teknik i autorizuar.</p>
E10	Ndarja e frigoriferit nuk është e ftohtë mjaftueshëm	<p>Ka të ngjarë të ndodhë pas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një ndërprerjeje energjie për kohë të gjatë. - Është lënë ushqim i nxehtë në frigorifer. 	<p>1. Vendosni temperaturën e frigoriferit në një vlerë më të ftohtë ose vendosni Super Ftohje. Kjo duhet të eliminojë kodin e gabimit pasi të arrihet temperatura e kërkuar. Mbajini dyert të mbyllura për të shkurtuar kohën që duhet për të arritur temperaturën e saktë.</p> <p>2. Ju lutem zbrazeni vendin në pjesën përpara të vrimave të kanaleve të tubacionit të ajrit dhe mos vendosni ushqime pranë sensorit.</p> <p>Nëse ky paralajmërim vazhdon, duhet të kontaktohet një teknik i autorizuar.</p>

LLOJI I GABIMIT	KUPTIMI	PSE	ÇFARË TË BËNI
E11	Pjesa e frigoriferit është shumë e ftohtë	Të ndryshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolloni nëse është aktivizuar metoda Super Ftohje 2. Ulni temperaturën e pjesës së frigoriferit 3. Kontrolloni për të parë nëse ajrimet janë të lira dhe nuk janë bllokuar. <p>Nëse ky paralajmërim vazhdon, duhet të kontaktohet një teknik i autorizuar.</p>

Nëse frigoriferi juaj nuk punon;

- A ka ndërprerje energjie?
- A është futur mirë spina në prizë?
- A është djegur siguresa e prizës në të cilën është lidhur spina ose a është djegur siguresa kryesore?
- A ka ndonjë defekt në prizë? Për të kontrolluar këtë, futeni frigoriferin në një prizë që e dini se punon.

Nëse frigoriferi juaj nuk ftoh mjaftueshëm:

- A është vendosur në rregull temperatura?
- A është hapur shpesh dera e frigoriferit dhe a është lënë hapur për kohë të gjatë?
- A është mbyllur mirë dera e frigoriferit?
- A keni vënë ndonjë enë ose ushqim në frigorifer që prek murin e pasmë të frigoriferit duke penguar kështu qarkullimin e ajrit?
- A është mbushur tepër frigoriferi?
- A ka distancë të mjaftueshme midis frigoriferit dhe murit të pasmë dhe mureve anësore?
- A është temperatura e ambientit brenda vlerave të përcaktuara në manualin e përdorimit?

A është ftohur tepër ushqimi në dhomën e frigoriferit

- A është vendosur në rregull temperatura?
- A janë vendosur shumë ushqime së fundi brenda dhomës të ngrirësit? Nëse po, frigoriferi mund të ftohë ushqimin brenda dhomës së frigoriferit pasi do të punojë për kohë më të gjatë për ta ftohur këtë ushqim.

Nëse frigoriferi juaj punon me shumë zhurmë;

Për të ruajtur nivelin e caktuar të ftohjes, mund të aktivizohet kompresori herë pas here. Zhurmat nga frigoriferi në këtë moment janë normale për shkak të punimit të tij. Kur arrihet niveli i kërkuar i ftohjes, zhurma do të ulet automatikisht. Nëse zhurmat vazhdojnë;

- A është pajisja në pozicion të palëvizshëm? A janë rregulluar këmbët?
- A ka ndonjë gjë prapa frigoriferit?
- A ka rafte ose enë mbi rafte që dridhen? Nëse po atëherë ndërroni raftet dhe/ose enët.
- A dridhen sendet që keni vendosur në frigorifer?

Zhurmat normale

Zhurme kërcitjeje (kërcitje akulli):

- Gjatë shkrirjes automatike.
- Kur pajisja ftohet ose ngrohet (për shkak të ekspansionit të materialit të pajisjes).

Kërcitje të shkurtra: Dëgjohen kur termostati ndez/fik kompresorin.

Zhurma e kompresorit (zhurmë normale motori): Kjo zhurmë do të thotë që kompresori punon normalisht. Kompresori mund të shkaktojë më shumë zhurmë për një kohë të shkurtër kur fillon.

Zhurme gurgullimi dhe spërkatjesh: Kjo zhurmë shkaktohet nga kalimi i lëngut ftohës në tubat e sistemit.

Zhurma e rrjedhës të ujit: Rrjedhë normale e ujit që kalon nga ena e avullimit gjatë shkrirjes. Kjo zhurmë mund të dëgjohet gjatë shkrirjes.

Zhurme e fryrjes të ajrit (zhurma normale e ventilatorit): Kjo zhurmë mund të dëgjohet në një frigorifer No-Frost gjatë punimit normal të sistemit për shkak të qarkullimit të ajrit.

Nëse grumbullohet lagështi brenda frigoriferit;

- A janë paketuar mirë ushqimet? A janë kontejnerët të thatë para se të vendosen në frigorifer?
- A janë hapur shpesh dyert e frigoriferit? Lagështia e dhomës hyn në frigorifer kur hapen dyert e frigoriferit. Lagështia grumbullohet më shpejt kur hapni dyert më shpesh, veçanërisht nëse lagështia e dhomës është e lartë.

Nëse dyert nuk hapen dhe mbyllen mirë;

- A pengojnë paketimet e ushqimeve mbylljen e derës?
- A janë vendosur mirë ndarjet, raftet dhe sirtarët?
- A janë çarë ose prishur gomat e derës?
- A është frigoriferi mbi sipërfaqe të niveluar?

Nëse anët e kabinetit të frigoriferit ku prek dera janë të ngrohta:

Në mot të nxehtë, sipërfaqet e kontakteve të bashkimeve mund të ngrohen më shumë gjatë punimit normal të kompresorit. Kjo është normale.


Shënime të rëndësishme:

- Do të aktivizohet funksioni i mbrojtjes së kompresorit pas ndërprerjeve të papritura të energjisë ose pas shkëputjes së pajisjes nga priza pasi gazi në sistemin e ftohjes nuk do të jetë stabilizuar. Frigoriferi juaj do të fillojë pas 5 minutash, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.
- Nëse nuk keni synim ta përdorni frigoriferin për kohë të gjatë (p.sh. në pushimet e verës), hiqeni nga priza dhe pastrojeni pasi të jetë bërë shkrirja (shiko PJESA 4). Lëreni derën të hapur për të parandaluar lagështinë dhe erërat.
- Nëse një problem vazhdon edhe pasi keni ndjekur të gjitha udhëzimet më sipër, ju lutem konsultohuni me qendrën më të afërt të shërbimit.
- Pajisja që keni blerë është bërë për përdorim familjar dhe mund të përdoret vetëm në shtëpi dhe për qëllimet e përcaktuara. Nuk është e përshtatshme për përdorim tregtar ose të zakonshëm. Nëse konsumatori e përdor pajisjen në një mënyrë që nuk përputhet me këtë, theksojmë se prodhuesi dhe shitësi nuk mbajnë përgjegjësi për asnjë riparim ose dëmtim brenda periudhës së garancisë.

Këshilla për ruajtjen e energjisë

1. Montojeni pajisjen në një dhomë të freskët, të ajrosur mirë, por jo nën dritën direkte të diellit dhe jo pranë burimeve të nxehtësisë (radiator, furrë, etj). Përndryshe përdorni pllakë izolimi.
2. Lërimi ushqimet dhe pijet e ngrohta të ftohen jashtë pajisjes.
3. Kur shkruani ushqime të ngrira, vendosini në dhomën e frigoriferit. Temperatura e ulët e ushqimit të ngrirë do të ndihmojë për të ftohur frigoriferin kur shkruhet. Në këtë mënyrë kurseni energji. Nëse nxirret ushqim i ngrirë, shkakton harxhim energjie.
4. Kur vendosni pije dhe lëngje ato duhet të mbulohen. Përndryshe krijohet lagështi në pajisje. Prandaj koha e punës bëhet më e gjatë. Gjithashtu mbulimi i pijeve dhe lëngjeve ndihmon për të ruajtur aromën dhe shijen.
5. Kur vendosni ushqime dhe pije, hapeni derën e pajisjes sa më pak kohë të jetë e mundur.
6. Mbani të mbyllur kapakët e çdo ndarjeje të ndryshme temperature në pajisje (krisper, çiller, ... etj.).
7. Rondela e derës duhet të jetë e pastër dhe elastike. Në rast të veshin, nëse copë litari juaj është i ndashëm, zëvendësoni rondelën. Nëse nuk është i ndashëm, duhet të zëvendësoni derën.
8. Funkzioni i regjimit Eko/rregullimit standard ruan ushqime të freskëta dhe të ngrira duke ruajtur energji.
9. Dhoma ose ndarja për ushqime të freskëta (Frigorifer): Përdorimi më efektiv i energjisë sigurohet në konfiguracionin me sirtarët në pjesën e poshtme të pajisjes, dhe raftet e radhitura njëtrajtshëm, pozita e rafteve të derës nuk e ndikon konsumin e energjisë.
10. Dhoma ose ndarja e ngrirë(Frigorifer ngrirës) Konfiguracioni i brendshëm i pajisjes është ajo e cila siguron përdorim më efektiv të energjisë.
11. Mos largoni akumulatorët e ftohtë nga kanistrat e frigoriferit ngrirës (nëse janë të pranishëm).

KAPITULLI - 7. PJESËT DHE ELEMENTET E FRIGORIFERIT



Kjo paraqitje është vetëm për informacion mbi pjesët e pajisjes. Pjesët mund të ndryshojnë në varësi të modelit të pajisjes.

A) Ndarja e Frigoriferit

B) Ndarja e Ngrirësit

- 1) Ekran i brendshëm / Kontroll në dhomë
- 2) Mbajtëse vere *
- 3) Rafti i frigoriferit
- 4) Dhoma Extra Chill (Ftohje Ekstra) *
- 5) Kapaku fruta dhe perime
- 6) Mbajtëse fruta dhe perime
- 7) Koshi i sipërm i ngrirësit

8) Koshi i mesit i ngrirësit

9) Koshi i poshtëm i ngrirësit

10) Këmbët e nivelimit

11) Tava e akullit

12) Raft xhami i ngrirësit *

13) Rafti i shisheve

14) Rafti e tek dera e frigoriferit

15) Mbajtësja e vezëve

* Në disa modele

KAPITULLI - 8. TË DHËNA TEKNIKE

Të dhënat teknike gjenden në pllakën e pasaportës në anën e brendshme të pajisjes dhe në etiketën e energjisë.

Kodi QR në etiketën e energjisë e furnizuar me pajisjes ofron vegzën e ueb-faqes së të dhënave sa i përket performancën e pajisjes në data bazën EPREL të BE.

Ruani etiketën e energjisë për referencë bashkë me doracakun dhe tërë dokumentet tjera që shkojnë bashkë me pajisjen.

Po ashtu është e mundur të gjeni të dhëna të njëjta në EPREL duke përdorur linkun <https://eprel.ec.europa.eu> dhe emrin e modelit dhe numrin e modelit të cilin e gjeni në pasaportën e të dhënave të pajisjes.

Shihni linkun www.theenergylabel.eu për të dhëna të hollësishme për etiketën e energjisë.

KAPITULLI - 9. TË DHËNA PËR INSTITUTET TESTUESE

Instalimi dhe përgatitja e pajisjes për çdo verifikim EcoDesign duhet të përkon me EN 62552. Kërkesat ose standardet e ventilimit, dimensionet vrimës dhe hapësirat minimale të prapme dihet të cekën në këtë Manual në KAPITULLI 1. Ju lutemi kontaktoni prodhuesin për ndonjë të dhënë tjetër, duke përfshirë edhe planet e ngarkesës.



МК

ОГАН

Предупредување; Опасност од пожар / запаливи материјали

СОДРЖИНА

ПРЕД ДА ЗАПОЧНЕТЕ СО УПОТРЕБА НА АПАРАТОТ	62
Општи предупредувања	62
Безбедносни предупредувања	67
Инсталација и ракување со вашиот фрижидер	68
Пред да го користите фрижидерот	69
Димензии	70
ИНФОРМАЦИИ ЗА УПОТРЕБА	71
Општи информации за новата технологија (незамрзнување)	71
Екран и контролен панел	72
Употреба на замрзнувачот на вашиот ладилник	72
Поставки за температурата во замрзнувачот	72
Поставки за температурата во ладилникот	72
Режим за супер-замрзнување	72
Аларм за отворена врата	73
Предупредувања за приспособување на температурата	73
Дополнителна опрема	74
Послужавник за мраз	74
Фиока во замрзнувачот	75
Преграда за екстра ладење	75
Копче за свежина	75
ОРГАНИЗИРАЊЕ НА ХРАНАТА ВО АПАРАТОТ	76
Оддел за ладење	76
Оддел за замрзнување	76
ЧИСТЕЊЕ И ОДРЖУВАЊЕ	80
Одмрзнување	80
ТРАНСПОРТ И ПРЕМЕСТУВАЊЕ	81
Менување на положбата на вратата	81
ПРЕД ДА ПОВИКАТЕ СЕРВИСЕР	81
Совети за заштеда на енергија	85
ДЕЛОВИ НА АПАРАТОТ И ОДДЕЛИТЕ	86
ТЕХНИЧКИ ПОДАТОЦИ	87
ИНФОРМАЦИИ ЗА ИНСТИТУТИ ЗА ТЕСТИРАЊЕ	87

МИСЛИМЕ НА ВАС

Ви благодариме што купивте апарат Electrolux . Избравте производ што носи со себе децении професионално искуство и иновации. Генијален и со модерен стил, дизајниран е мислејќи на вас. Секогаш кога ќе го користите, можете да бидете сигурни дека секој пат ќе добиете одлични резултати.

Добре дојдовте во Electrolux.

Посетете ја нашата веб-страница за да:



Добиете совети за употреба, брошури, решавање на проблеми, услуги за сервисирање и поправка:

www.electrolux.com/support



Регистрирајте го вашиот производ за подобра услуга:

www.registerelectrolux.com



Купете додатоци, потрошни материјали и оригинални резервни делови за вашиот уред:

www.electrolux.com/shop

ГРИЖА ЗА КОРИСНИЦИ И СЕРВИС


Секогаш користете само оригинални делови.

Кога контактирате со нашиот овластен сервисен центар, проверете дали ги имате следниве податоци: Модел, PNC, сервиски број.

Информациите може да се најдат на плочката со спецификации.

 Предупредување / Внимание-Безбедносни информации

 Општи информации и совети

 Информации за животната средина

Предмет на промени без претходно известување.

Општи предупредувања

Прочитајте го внимателно прирачникот пред да го инсталирате и користите вашиот уред. Нашата компанија нема да биде одговорна во случај на злоупотреба.

Следете ги сите инструкции на уредот и во прирачникот, и чувајте го прирачникот на сигурно за да можете да решите идни можни проблеми.

Овој уред не е наменет да се користи како вграден апарат.

При монтажа кога апаратот не е самостоен, почитувајќи го потребниот простор за димензиите при употреба, апаратот ќе работи правилно, но потрошувачката на енергија може малку да се зголеми.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Не ги блокирајте отворите за вентилација кои се најдуваат во кутијата на уредот или во вградената структура.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Немојте да користите механички уреди или други начини за забрзување на процесот на одмрзнување, освен оние кои се препорачани од производителот.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Немојте да користите електрични уреди во внатрешните оддели на уредот, освен доколку не се од вид кој е препорачан од производителот.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Не го оштетувајте колото на разладувачот.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Кога го позиционирате уредот, гледајте кабелот за струја да не биде заглавен или оштетен.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: Немојте да поставувате повеќе продолжни кабли или утикачи на задниот дел од уредот.

⚠ ПРЕДУПРЕДУВАЊЕ: За да се спречи опасност поради нестабилност на уредот, мора да се фиксира според инструкциите.

⚠ Ако вашиот уред користи R600a како рефригерант – можете да ја видите оваа информација на етикетата на ладилникот – треба да внимавате за време на транспорт и монтажа да не ги оштетите разладните елементи на ладилникот. Иако тој е пријателски спрема околината и природен, експлозивен е. Во случај на истекување поради оштетување на елементите на ладилникот, оддалечете го уредот од извори на оган или топлина и проветрете ја собата неколку минути.

- Чувајте ја целата амбалажа подалеку од деца и отстранувајте ја соодветно.
- Додека го носите и преместувате фрижидерот, внимавајте да не го оштетите колото на гасот.
- Немојте да чувате експлозивни материи, како на пример кутии со аеросол со запалив пропелент, во овој уред.
- Уредот служи само за складирање храна и пијалаци.
- Уредот е наменет да го користи едно домаќинство во домашни услови во затворен простор.
- Уредот може да се користи во канцеларии, хотелски соби, гостилници, фарми со гостилници и други слични сместувања каде неговото користење не надминува (просечно) ниво на користење во домаќинство.
